



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 219, Datë 10.08.2026

MBI

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2026 PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 110, pika 4 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2384/1 prot., datë 07.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Korrik 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

I -Aspektet Ligjore dhe Procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 4784 prot., datë 03.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 2384 prot., datë 03.08.2026 ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 110, pika 4, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

II – Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin Korrik 2026, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë

(ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin Korrik 2026 në vlerën 11.32 lekë/kWh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 11.32 lekë/kWh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (Neni 8, vendimi nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për muajin Korrik 2026: **11.32 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të bordit të ERE nr. 312, datë 12.12.2025, “Mbi lënien në fuqi deri më 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike” të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kWh;**
- **Kostot administrative:** **1.06 lekë/kWh;**
- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **30.06.2026 – 30.07.2026.**
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2026, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin korrik 2026</i>			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	11.32
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.34
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	15.12

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton *15.12 Lekë/kWh për muajin Korrik 2026*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2026 prej 15.12 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI